Accessible Quality Healthcare
Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor
Pristupačna i Kvalitetna Zdravstvena Zaštita

SDC project implemented by Swiss TPH

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

BULETINI, NR.2,
MAJ 2020

PËRGJIGJA E PROJEKTIT AQH NDAJ SHPËRTHIMIT TË COVID-19

AQH DORËZON FURNIZIMET BAZIKE TEK KOMUNAT NË MBËSHTETJE PËR PERIUDHËN E COVID-19

Gjatë javës së kaluar, një grumbull i materialeve të informacionit, artikujve mbrojtës higjienik dhe paketave ushqimore thelbësore iu janë dorëzuar përfaqësuesve të Shtabit Komunal të Emergjencave në Lipjan, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Obiliq, Vushtrri, Gracanicë, Rahovec, Malishevë, Skenderaj dhe Gjakovë për të mbështetur Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptiane kundër COVID-19.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe shtabet komunale të emergjencave, deri në 3000 familje perfituan nga kjo mbeshtetje e ofruar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit të saj AQH.

Kryetari i Lipjanit, Imri Ahmeti, i cili ishte i pranishëm në arritjen e donacioneve më të fundit, tregoi mbështetjen e tij gjatë tërë procesit, siç shihet në fotot e mësipërme.

Në disa komuna, shpërndarja e materialit tek përfituesit përfundimtarë është duke vazhduar edhe tani, ndërsa ekipi i projektit dhe përfaqësuesit e EHM janë duke e ndjekur atë.

AUDITI KLINIK NË DISTANCË DHE SESIONET E RISHYQRTIMIT KOLEGIAL NË DISTANCË PËR SITUATAT EMERGJENTE



Për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të Shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH), veçanërisht gjatë situatave emergjente në lidhje me COVID-19, AQH po mbështet Koordinatorët e Cilësisë nga 12 pilot QKMF-të në procesin e punës. Dy ekspertë lokalë kanë përfunduar me sukses procesin e planifikimit të ofrimit të seancave të mentorimit në distancë se si të shfrytëzojnë sa më shumë këtë mundësi zhvillimi. Përmes ekspertizës së fituar, koordinatorët e cilësisë janë duke punuar në identifikimin e temave/çështjeve përkatëse dhe kryerjen e Auditeve Klinike dhe Sesioneve të Rishikimit Kolegial.

VIDEO PËR DISTANCIMIN SOCIAL 'RRI N'SHPI. MBROJE JETËN.'

Video 'Rri n'Shpi. Mbroje jetën.' e cila synon vetëdijesimin mbi rëndësinë e distancimit social gjatë periudhës së COVID-19 është shikuar nga 184.000 njerëz në faqen e AQH-së në Facebook.

Në bashkëpunim me MSH-në dhe IKSHP-në ne vazhdojmë të transmetojmë videon në televizione kombëtare dhe tregtare rregullisht.

Nëse nuk e keni parë, ju lutemi klikoni [këtu] për të parë videon.



QASJA E KUJDESIT TË INTEGRUAR

Një nga objektivat kryesore të projektit është të mbështesë ofruesit e KPSH që të ofrojnë shërbime cilësore për pacientët kronikë, gjë që është edhe më e rëndësishme gjatë periudhës aktuale pandemike pasi SJN-të janë faktorët kryesorë të rrezikut për pacientët me COVID-19.

Materialet informuese për pacientët me SJN të zhvilluara nga AQH në bashkëpunim me MSH-në dhe IKSHP-në

Përmes takimeve virtuale, ekipi i projektit dhe përfaqësuesit e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Lipjanit po diskutojnë mundësitë e shkëmbimit të përvojave dhe pilotimit të mjeteve të kujdesit të integruar për pacientët që janë mbi 65 vjeç me diabet të tipit 2. Përvoja e zbatimit të projektit në Komunën e Fushë Kosovës do jetë baza mbi të cilën do punohet tutje. Përshtatja dhe rishikimi i mjeteve të modelit duhet të ketë parasysh rrezikun e COVID-19 në implementim. Hapat e ardhshëm do t'i referohen përgatitjeve të shërbimeve të integruara shëndetësore dhe të aspektit social për pacientët me SJN ku do të testohen dhe planet individuale për secilin pacient.

Për më shumë informata rreth projektit, ju lutem na ndiqni në rrjetet tona sociale: